

# RAIFFEISENER PROGRAMI I PRAKTIKËS



**Raiffeisen  
BANK**

... JETO MË MIRË

## Fillo karrierën me Raiffeisen!

Përmes Programit të Praktikës "Raiffeisener" ju ndihmojmë të bëni hapat e parë në një ndër industritë më dinamike në treg, për të pasur më pas mundësi të ngriteni profesionalisht në karrierë.

### Fillo karrierën me Raiffeisen! Bëhu Raiffeisener!

Keni aftësi, vullnet për punë, përkushtim dhe motivim për t'u bërë pjesë e njëres prej bankave lidere në vend? Jeni në kërkim të zbulimit të interesimeve tuaja në lidhje me orientimin e karrierës suaj? Zgjedhni bankën Raiffeisen, dhe bëhuni pjesë e programit të praktikës Raiffeisener.

Programi i Praktikës Raiffeisener ju ndihmon të bëni hapat e parë në një ndër industritë më dinamike në treg, për të pasur më pas mundësi të ngriteni profesionalisht dhe të formësoni shtegun tuaj të karrierës.

Si Raiffeisener, ju do të keni mundësi t'i ekspozoheni aktiviteteve ditore të punës në bankë dhe të përfitoni njohuri të reja, të praktikoni njohuritë e fituara në studime dhe të formësoni shprehitë e punës.

Programi i praktikës zgjat dy muaj:  
**01 korrik - 31 gusht 2016**

**18%** të të punësuarëve aktual në Bankën Raiffeisen kanë qenë praktikantë.

Nëse përmbushni kriteret e kërkuara, jeni të motivuar, përkushtuar dhe keni vision për karrierë, banka Raiffeisen ju fton të aplikoni për Praktikë, sipas informatave në vijim:

#### Procesi i përzgjedhjes:

- Afati për aplikim: 12 maj - 24 maj 2016;
- Aplikimi vetëm përmes sistemit on-line, përmes webfaqes [www.raiffeisen-kosovo.com](http://www.raiffeisen-kosovo.com). Duke klikuar në fushën Karriera, zgjedhni Programi i praktikës, dhe pastaj klikoni linkun: Aplikacion për praktikë - Raiffeisener.
- Të gjitha të dhënat e paraqitura në aplikacion do të verifikohen. Aplikacionet të cilat rezultojnë me të dhëna joreale do të refuzohen.

#### Kriteret për aplikim:

- Studentë të Fakultetit Ekonomik, Juridik dhe të fushës së Teknologjisë Informative të Universitetit të Prishtinës, Kolegjeve Private të Akredituara, si dhe Universiteteve jashtë vendit;
- Nota mesatare 7.5 e më lartë;
- Për studentët e Kolegjit AUK nota mesatare 2.8 e më lartë;
- Studentët e vitit të fundit të studimeve Bachelor;
- Letërnjoftim ose pasaportë valide të Republikës së Kosovës;
- Aftësi shumë të mira të gjuhës angleze dhe punës me kompjuter;
- Gatishmëri për të punuar me orar të plotë të punës (40 orë në javë)

#### Procesi i përzgjedhjes:

Të gjithë studentët që përmbushin kriteret e lartëpërmendura do të ftohen për testim, për të testuar: njohuritë në fushën e ekonomisë, aftësitë logjike & matematikë, aftësitë e gjuhës angleze.

Studentët në test nevojiten të kenë me vete një vërtetim zyrtar nga Fakulteti përkatës që dëshmon vitin e studimeve dhe notën mesatare.

Vetëm studentët që kalojnë testin me sukses, do të ftohen për fazën e intervistës, e cila do të jetë e kombinuar (intervistë grupore dhe individuale).

#### Përfitimet shtesë:

- Mundësi zhvillimi të njohurive duke kombinuar teorinë me praktikën;
- Certifikim nga banka Raiffeisen për kryerje të praktikës;
- Përgatitje për treg të punës, duke përfituar nga përvoja unike e praktikës në bankën Raiffeisen;
- Lidhja e miqësive të reja dhe
- Programi i praktikës është me pagesë
- Mundësi punësimi në bankën Raiffeisen.